

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, të mbajtur më 21.05.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit të gjykatave (“Gazeta Zyrtare e RM” 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe (2), neni 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi kërkesën për miratimin e qëndrimit parimor, të paraqitur nga Dimitrija Dimoski, avokat nga Gostivari, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Kërkesa e paraqitur nga Dimitrija Dimoski, avokat nga Gostivari për miratim të qëndrimit parimor, e evidentuar nën SU-03.nr.25/24 të datës 15.01.2024, **NUK MIRATOHET.**

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave (“Gazeta Zyrtare e RM” 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 21.05.2024, shqyrtoi mbi kërkesën për miratim të qëndrimit parimor, të paraqitur nga Dimitrija Dimoski, avokat nga Gostivari ndërsa lidhur me veprimin e lëndëve penale në gjykatat, nga gjyqtarë me 2 – dy vjet përvojë.

Paraqitësi i kërkesës kërkon që, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të merr qëndrim parimor apo mendim, lidhur me pyetjet si vijojnë: 1. A mundet që një gjyqtar që ka deri në 2-dy vjet përvojë të vendos si gjykatës i procedurës paraprake dhe të merr vendime përkatëse? Pastaj, paraqitësi sqaron se kjo ka të bëjë me marrjen e veprimeve hetuese, si për shembull bastisje, në mënyrë që është e mundshme të rezultojnë prova që çojnë në një vepër më të rëndë penale, për të cilën parashihet dënim me burgim me mbi 5 - pesë vjet. 2. A mund që një gjyqtar që ka 2 – dy vjet përvojë të vendos për caktimin e masës së paraburgimit për vepër penale për të cilën parashihet dënim me burgim me mbi 5 – pesë vjet? 3. A mund që një gjyqtar që ka 2 – dy vjet përvojë të merr pjesë në lëndë penale për të mitur ose në këshill penal për të mitur si anëtar i të njëjtit?

Paraqitësi i referohet dispozitës së nenit 30 paragrafi (1) të Ligjit të gjykatave, në të cilën nuk është theksuar se gjyqtari është i autorizuar që të vendos edhe në procedurën paraprake dhe të ngjashme. Më tutje, paraqitësi tregon ekzistimin e praktikës së ndryshme gjyqësore dhe veprim të ndryshëm në gjykatat e tërë vendit, në mënyrë që konstaton se janë plotësuar kushtet për marrjen e qëndrimit parimor mbi çështjet e theksuara. Në këtë mënyrë do të zgjidheshin kundërthëniet dhe do të largoheshin situatat kur provat dhe vendimet gjyqësore të marra nga gjyqtarët me 2-dy vjet përvojë, do të shpallehin si të paligjshme dhe do të konstatohej cenimi i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Nga këtu, paraqitësi konsideron se me marrjen e një qëndrimi parimor apo mendimi mbi pyetjet në fjalë në mënyrë të denjë do të respektohej parimi i sundimit të së

drejtës, zbatimi unik dhe konsekuent i ligjeve dhe praktikë e barabartë gjyqësore në tërë vendin.

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje të rëndësishme për sigurimin e barazisë në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tre muajve, por jo më gjatë se gjashtë muaj me vetiniciativë apo me iniciativë të kryetarit të gjykatës apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo sektorëve gjyqësor të gjykatave apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Dukshëm nga përmbajtja e kërkesës, paraqitësi tregon ekzistimin e një praktike të ndryshme gjyqësore dhe veprimin e ndryshëm në gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por në mbështetje të këtyre të dhënave nuk janë dorëzuar prova relevante përkatësisht vendime gjyqësore, nga të cilat do të rezultonte praktikë e ndryshme gjyqësore sa i përket pyetjeve të parashtruara.

Duke marrë parasysh të sipërcituarën, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, vlerëson se në rastin konkret nuk janë të plotësuara kushtet ligjore nga neni 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave, përkatësisht nuk ka praktikë jo të barabartë gjyqësore në gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

SEANCA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT